

#Aksioni për Bunën

Konkursi i fotografive në Facebook 16 - 26 Shtator, 2019

Ligatinat dhe njerëzit, një konkurs fotografish

TERMAT DHE KUSHTET

Termtat dhe Kushtet e mëposhtme zbatohen për konkursin #Aksioni për Bunën në Facebook.

Me pjesëmarrjen e kandidatëve që pranojnë termtat dhe kushtet e plota të përfshira këtu.

Konkursi i organizuar nga Projekti Living Buna, në bashkëpunim me NAPA dhe RAPA Shkodër, për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e ligatinave për njerëzit dhe mirëqënien e tyre, tani dhe në të ardhmen.

Konkursi përfshin postimin e fotos të realizuar në Peisazhin e Mbrojtur të Lumit Buna-Velipojë (BRVPL) që ndodhet në Bashkinë e Shkodrës përmes Facebook, duke përdorur me hashtag #Aksioni për Bunën.

RREGULLAT E PJESËMARRJES

- Konkursi është i hapur për qytetarët shqiptarë. Punonjësit e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ,OJF-të mbështetëse dhe ekipi i projektit nuk kanë të drejtë të marrin pjesë
- Pjesëmarrja synon të paraqesë dhe promovojë ligatinat dhe vlerat e lumit Buna në Shqipëri.
- Nuk ka kufizime në lidhje me numrin e fotove të përcjella nga çdo pjesëmarrës. Fotografia mund të realizohet me aparat celular, aparat fotografik ose pajisje tjetër.
- Nuk kërkohet rregjistrim. Pjesëmarrja rregjistrohet përmes postimit të fotos në Facebook në faqen #Aksione për Bunën. Të gjitha postimet duhet të jenë “publike” në mënyrë që të aksesohen nga juria dhe të jenë të dukshme për ekipin e projektit.
- Postimet duhet të realizohen ne facebook përpara datës 26 shtator 2019 ne 23 :59 . Të gjitha postimet pas këtij afati nuk do të meren në konsideratë. Stafi i projektit nuk mban përgjegjësi për problemet që mund të shoqërojnë postimin si pasojë e mungesës apo problemeve me internetin apo problem tjetër të mundshëm.

- Kur postoni foton vendndodhja duhet përcaktuar
- Fotot mund të korrektohen apo të përdoren filtra, por jo të manipulohen sa l takon kontekstit.
- Projekti ruan të drejtën të përjashtojë pjesëmarrësit që paraqesin foto me përmbajtje të turpshme, dhune, diskriminimi e gjithçka që mund të çënojë të drejtat e njeriut Gjithashtu ato nuk duhet të shkelin parimin e ruajtjes së privatësisë së personave.
- Nuk lejohet: lidhja/referimi l institucioneve, partive politike apo simboleve te institucioneve, etj.
- Me postimin e fotos në Facebook dhe përdorimin e hashtag AkKsioni per Bunen, pjesëmarrësi në konkurs pranon që fotot e tij mund të përdoren nga stafi i projektit për qëllime komunikimi.
- Stafi i projektit do të njoftojë fituesit me rezultatet e sfidës. Nëse fituesi nuk mund të kontaktohet pas disa përpjekjeve, stafi i projektit ruan të drejtën të kontaktojë më të mirin në radhë të përzgjedhur.

Periudha e dorëzimit 17-26 Shtator 2019 ne 23:59 CET.

Cmimet

Fituesit do të shpallen më 28 Shtator, gjatë festimeve të Ditës së Bregdetit në qendrën e vizitorëve, Velipojë. 3 fotot e përzgjedhura do të marrin botime ekskluzive të fotografisë në natyrë.

Procesi i seleksionimit

Një juri e përbërë nga përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe përfaqësues të shoqërisë civile do të përzgjedhë 3 fotot më të mira.

Kriteret e vlerësimit janë (a) kreativiteti; (b) përmbajtja dhe (c) kompozicioni

Pjesëmarrësit pranojnë të gjitha KRITERET E MËSIPËRME.

Për më shumë informacion ju lutem shkruani tek adresa: aleksandra.nikodinovic@iucn.org.